

# ANKETA E BUXHETIT TË NJËSIVE EKONOMIKE FAMILJARE

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

## Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse .....	4
5. Periudha e referencës .....	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti .....	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	5
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	5
11. Manaxhimi i cilësisë .....	6
12. Rëndësia.....	6
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	7
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	8
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	8
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor .....	9
19. Komente.....	10
Aneks .....	10

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Konsumit të Familjeve, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Anisa Omuri
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës në Sektori i Statistikave të Konsumit të Familjeve
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:aomuri@instat.gov.al">aomuri@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	29.12.2023
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	29.12.2023
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	29.12.2023
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Anketa e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF) dhe jep një panoramë të situatës socio-ekonomike të NjEF në Shqipëri.</p> <p>Objekti kryesor i mbledhjes së të dhënave është përlogaritja e nivelit dhe strukturës së shpenzimeve të konsumit të Njësive Ekonomike Familjare (NjEF) në Shqipëri në nivel vendi dhe sipas qarqeve, si dhe të treguesve të tjerë bazuar në shpenzimet e konsumit. Avantazhi i Anketës së Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare mbi burimet e tjera të informacionit për konsumin është se vrojtimi merr informacion në nivel familje, anketa gjithashtu merr informacion rreth karakteristikave socio- demografike të pjesëtarëve të saj si dhe të njësive ekonomike familjare.</p> <p>Të dhënat e Anketës së Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare përdoren për përditësimin e Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe llogaritjen e Konsumit Final të Familjeve si një agregat i rëndësishëm i Llogarive Kombëtare. Mbajtja i një ditari dhe fletorese të vetë-konsumit të detajuar të shpenzimeve të familjeve</p>

	<p>gjatë periudhës një-javore nga familjet e përzgjedhura është veçoria kryesore e ABF-së.</p>
3.2. Sistemi i klasifikimit	<p>ABF mbledh informacion mbi shpenzimet e konsumit sipas klasifikimeve të mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit, <a href="#">COICOP-5 shifror</a></li> <li>2. Klasifikimi Europian i Aktiviteteve Ekonomike, <a href="#">NACE rev2</a></li> <li>3. Sistemi i Klasifikimit Ndërkombëtar të Standardeve të Arsimit, <a href="#">ISCED 2011</a></li> </ol>
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Grupet kryesore të konsumit janë përcaktuar sipas Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP), 2012 si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ushqime dhe pije jo-alkoolike</li> <li>2. Pije alkoolike, duhan</li> <li>3. Veshje dhe Këpucë</li> <li>4. Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike, qira të paguar</li> <li>5. Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës</li> <li>6. Shëndet</li> <li>7. Transport</li> <li>8. Komunikim</li> <li>9. Argëtimi dhe kulturë</li> <li>10. Arsim</li> <li>11. Restorante dhe hotele</li> <li>12. Të tjera mallra dhe shërbime</li> </ol>
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p><b>Shpenzimet për konsum të NjEF</b> përfshijnë çdo lloj blerjeje produktesh dhe shërbimesh për të plotësuar nevojat individuale të NjEF dhe individëve me përjashtim të blerjeve për pajisje afatgjatë, investimeve kapitale, parave për të tretët dhe qirasë së imputuar.</p> <p><b>Periudha e referencës</b> është kohëzgjatja së cilës i referohet një çështje e caktuar informacioni. Anketa përdor periudha të ndryshme reference në varësi të tipit të informacionit që duhet marrë dhe objektivave të secilës çështje për t'u analizuar.</p> <p><b>Një njësi ekonomike familjare (NjEF)</b> i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.</p> <p><b>Kryefamijari</b> është një person, që përcaktohet si i tillë për qëllimet e anketës (person që është pronar i banesës ose person i identifikuar si i tillë nga anëtarët e tjerë të NjEF). Nëse anëtarët e NjEF nuk e përcaktojnë vetë këtë person, normalisht do të jetë personi që kontribuon më shumë në të ardhurat totale të NjEF.</p> <p><b>Fëmijë</b> është konsideruar çdo individ nën moshën 18 vjeç.</p>
3.5. Njësia statistikore	<p>Njësia statistikore është Njësia Ekonomike Familjare.</p>
3.6. Popullata statistikore	<p>Popullata statistikore janë të gjitha NjEF me vendbanim të zakonshëm në</p>

	<p>Shqipëri.</p> <p>Kampioni i vrojtimit mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë.</p>
3.7. Zona e referencës	<p>ABF mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë. Banesat kolektive, shtëpitë për të moshuarit, spitalet, shtëpitë e rehabilitimit, duke përfshirë spitalet për fëmijë, shkollat me konvikte, hotelet, sanaturimet, institucione korrektuese dhe penale nuk janë të përfshira në vrojtimit.</p>
3.8. Mbulimi në kohë	<p>ABF ka një shtrirje kohore një vjeçare në terren. Të dhënat e mbuluara nga ABF datojnë që nga viti 2006 -2007, 2008-2009 dhe 2014 e në vazhdim.</p>
3.9. Periudha bazë	<p>Nuk është e aplikueshme për ABF.</p>
<b>4. Njësia matëse</b>	<p>Shpenzimet për konsum të NjEF janë të matura në Lekë të reja.</p>
<b>5. Periudha e referencës</b>	<p>Periudha e referencës është viti i plotë, Janar - Dhjetor 2022.</p>
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Në nivel kombëtar, Statistikat e ABF janë bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">LIGJ Nr. 17/2018</a> “PËR STATISTIKAT ZYRTARE”.</li> <li>• <a href="#">Programin Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026</a></li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	<p>Nuk është e aplikueshme për ABF.</p>
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura nga NjEF konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>Të gjitha të dhënat individuale të mbledhura nga njësia statistikore për nxjerrjen e statistikave zyrtare përdoren vetëm për qëllime statistikore. Këto të dhëna botohen vetëm bashkërisht dhe nuk përdoren për të marrë ndonjë vendim administrativ, duke përfshirë këtu vendime për kontrollin fiskal ose hetime</p>

	juridike.
<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve	<a href="#">Kalendari i publikimeve</a> është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT-it.
8.3. Aksesit i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta.  Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e vrojtimit ABF janë si më poshtë:  <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Website – online release</li> <li>2. Kërkesat e shkruara</li> <li>3. Publikimet (publikimi vjetor i rezultateve të ABF-së, Vjetari Statistikor Rajonal, Vjetari Statistikor, Shqipëria në Shifra)</li> <li>4. Pjesa e <a href="#">Informacionit të dedikuar</a> për të kontaktuar INSTAT.</li> </ol>
<b>9. Shpeshtësia e shpërndarjes</b>	Rezultatet e ABF publikohen në baza vjetore.
<b>10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë si shpenzimet mesatare mujore për konsum të NjEF, shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas qarqeve, tipologjisë së familjeve etj. dhe publikohet në faqen web të INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet e ABF gjenden të botuara në Vjetarin Statistikor dhe atë Rajonal. Përdoruesit mund ti gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT: <a href="#">Anketa e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare</a>
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e ABF nga viti 2006/2007 2008/2009 dhe 2014 e në vazhdim. Gjithashtu në faqen web të INSTAT ka një shpjegim të shkurtër hyrës metodologjik. Bazën e të dhënave mbi shpenzimet e konsumit të familjeve e aksesoni në linkun: <a href="#">Databaza</a> .

10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat e ABF nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për <a href="#">Kontakt</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <a href="#">Metodologjinë</a> mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Spektori i Statistikave të Konsumit të Familjeve dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ABF për qëllime të brendshme.
<b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për statistikën Zyrtare”, Nr.17/2018, datë 17.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve. Procesi i hedhjes së të dhënave, është i programuar që të minimizojë gabimet që vijnë nga procesi i mbledhjes së të dhënave. Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave merren masa për të reduktuar mos-përgjigjet. Të dhënat e mbledhura krahasohen në lidhje me koherencën e brendshme, burimet administrative apo anketat e tjera pranë familjeve që INSTAT realizon duke garantuar një produkt final cilësor.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e ABF krahasohen me të dhënat e ABF në vitet e kaluara për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e ABF-së ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm. Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Institucione të administratës publike</li> <li>• Universitetet</li> <li>• Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare</li> <li>• Bizneset</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme.</li> </ul> <p>Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin rezultatet e ABF si input në punën e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtoria e Llogarive Kombëtare</li> <li>• Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real.</li> </ul>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me Anketën e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare për vitin 2022 janë rreth 8.896 klikime.</p> <p>Gjatë 2022 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave për fushën e Konsumit të Familjes është vlerësuar me 3.66 (73.2%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Anketa e ABF kryet bazuar në Marrëveshjen e BE (gentlemen’s agreement), ku secili shtet anëtar vendos objektivat, metodologjinë dhe frekuencën e kryerjes së vrojtimit. Bazuar në këtë marrëveshje, plotshmëria e të dhënave të ABF është në përputhje të plotë me objektivat e përcaktuara nga INSTAT.</p> <p>Shkalla e plotshmërisë së të dhënave për Anketën e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare, është 100%.</p>
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Çdo anketë e zhvilluar nga INSTAT bazohet në zgjedhjen e një kampioni për të nxjerrë përfundime për popullsinë në vrojtimit. Natyrshëm, ky proces shoqërohet me devijime statistikore. Për këtë arsye u llogaritën devijimet standarde të zgjedhjes të cilat përdoren për interpretimin e rezultateve të anketës.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Në vitin 2022, kampioni i anketës së buxhetit të njësive ekonomike familjare u llogarit 10.452 NjEF. Në përfundim të vrojtimit u intervistuan rreth 7.666 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë.</p> <p>Shkalla e përgjigjes së NjEF, e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 73.3%. Për Anketën e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare 2022, janë llogaritur devijimet standarde të përgjithshme të zgjedhjes. Në tabelat A1 dhe A2 në Aneks jepen devijimet standarde dhe koeficientet e variacionit të shpenzimeve mesatare mujore për konsum sipas 12 grupeve kryesore të konsumit si dhe shpenzimet mesatare për konsum mujor sipas 12 qarqeve.</p>
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë familjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur familjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën. Shkalla e Mos-përgjigjes nivel rekordi e papeshuar është 26.7 %.</p> <p>Shkalla e mbi-mbulimit, tregon se sa përqind e familjeve nuk duhet të ishin pjesë e anketës, pasi janë jashtë fokusit të anketës. Shkalla e mbi-mbulimit për</p>



	ABF 2022 është 3.0%.								
<b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e ABF-së janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT, 277 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 277 ditë). Periudha referuese e rezultateve të ABF 2022 është 31 Dhjetori 2022.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>10/4/2023</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>277</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2023	Data e publikimit	10/4/2023	Afatet kohore	277		
Periudha referuese	12/31/2023								
Data e publikimit	10/4/2023								
Afatet kohore	277								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat finale të ABF publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i ABF 2022, ka qenë i përpiktë në kohë në 100% të publikime të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>10/4/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>10/4/2023</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e shpallur	10/4/2023	Data e publikimit	10/4/2023	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2022								
Data e shpallur	10/4/2023								
Data e publikimit	10/4/2023								
Vonesa në kohë	0								
<b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b>									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Të dhënat mbi treguesit e ABF janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat dhe si të tilla janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat janë gjithëpërfshirëse dhe prodhohen në nivel vendi dhe qarku.</p>								
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Anketa e Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare është realizuar nga INSTAT në këto vite: 2006- 2007, 2008-2009 dhe prej vitit 2014 është realizuar në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p>Periudha e referencës së mbledhjes së të dhënave për vrojtimin e vitit 2019 dhe në vazhdim ndryshon nga vrojtimit e mëparshme të buxhetit të familjeve, ku ditari dhe fletorja e vetë-konsumit mbledh të dhëna me periudhë reference 1 javë për të gjithë kampionin.</p> <p>Metodologjia ndër vite është përgjithësisht e njëjtë duke mundësuar një krahasueshmëri kohore ndër vite. Që nga viti 2014, Anketa e Buxhetit të Familjeve realizohet në mënyrë të vazhdueshme duke mundësuar një krahasueshmëri në seri kohore prej 9 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=9).</p>								
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	<p>Kontrolle të rregullta të ndërthurura realizohen me informacione nga burime të tjera të INSTAT pasi rezultatet e këtij vrojtimi përdoren gjithashtu për përditësimin e Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe llogaritjen e Konsumit Final të Familjeve si një agregat i rëndësishëm i PBB me metodën e shpenzimeve.</p>								
15.4. Koherenca e brendshme	<p>Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre.</p>								



<p><b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b></p>	<p>Personat që punojnë për ABF janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Stafi i përgjithshëm në Zyrat Qendrore: 4 punonjës</li> <li>• Stafi në Zyrat Rajonale, 28 punonjës</li> <li>• Intervistuesit, Operator, Kontrollor (Staf i përkohshëm i INSTAT): 81 Intervistues + 6 Kontrollorë + 7 Operatorë.</li> </ul>
<p><b>17. Rishikimi i të dhënave</b></p>	
<p>17.1. Politika e rishikimit</p>	<p>Politikat e rishikimit të ABF bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e Revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e Trajtimit të Gabimeve</a></li> </ul>
<p>17.2. Praktika e rishikimit</p>	<p>Në fund të muajit Maj 2014, INSTAT publikoi shifrat e plota të popullsisë për vitet 2001-2014 të cilat reflektonin ndryshimet e popullsisë që vinin nga Censusi i Popullsisë dhe Banesave 2011. Këto shifra, si numri i popullsisë, numri i Njësive Ekonomike Familjare, popullsia sipas grup-moshave etj. sjellin ndryshime në përlogaritjet e treguesve të tjerë me bazë popullsinë.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime mbi të dhënat e Anketës të Buxhetit të Njësive Ekonomike Familjare për vitin 2022, subjekt i këtij raporti.</p>
<p><b>18. Përpunimi statistikor</b></p>	
<p>18.1. Burimi i të dhënave</p>	<p>Si burim i vetëm i mbledhjes së të dhënave është vrojtimi i ABF.</p>
<p>18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave</p>	<p>Të dhënat mblidhen në bazë vjetore.</p>
<p>18.3. Grumbullimi i të dhënave</p>	<p>Mbledhja e të dhënave bazohet në dy mënyra të ndryshme të mbledhjes së informacionit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Plotësimi i një ditari të blerjeve (si dhe fletorja e vetë-konsumit sa herë që NjEF deklaron se konsumon artikuj apo shërbime që i prodhon vetë) nga ana e NjEF për një periudhë reference 7 ditore.</li> <li>• Kryerja e një interviste direkte nëpërmjet intervistuesit në javën e parë të muajit pasardhës me periudhë reference muajin në të cilin është plotësuar ditari i blerjeve/fletorja e vetë-konsumit.</li> </ul>
<p>18.4. Vlefshmëria e të dhënave</p>	<p>Sa i përket vlefshmërisë së të dhënave, procedurat e editimit të të dhënave në përgjithësi i referohen editimit në nivel mikro ose ndryshe në nivel NjEF.</p> <p>1. Kontrolli fizik i pyetësorit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli i pyetësorëve të mbledhur, kontrolle lidhur me plotshmërinë, saktësisë së vlerave dhe kontrollet logjike të pyetësorit. Kontrollorët e anketës kanë një program specifik për të kryer kontrollin fizik të pyetësorëve. Numri i pyetësorëve të mbledhur duhet të jetë i barabartë me</li> </ul>

	<p>numrin e pyetësorëve të shpërndarë në qarqe.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kontrolle individuale janë bërë për rastet e refuzimit dhe pa kontakte.</li> </ul> <p>2. Korrigjimet aritmetike, korrigjimet logjike dhe verifikim i koherencës midis pjesëve të ndryshme të pyetësorit. Pas procesit të hedhjes të të dhënave realizohet procesi i pastrimit dhe imputimit të të dhënave duke përdorur programet kompjuterike SCIA dhe RIDA.</p>				
18.5. Përpilimi i të dhënave	<p>Për përpilimin e rezultateve kemi dy procedura bazë:</p> <p><b>1. Analiza e cilësisë së të dhënave</b></p> <p>Për të analizuar cilësinë e të dhënave janë aplikuar disa rregulla:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kontroli matematik i anketës</li> <li>Kontroli logjik i të dhënave të anketës</li> <li>Krahasimi i të dhënave në seri kohore</li> <li>Krahasimi i të dhënave me skedarë të tjerë që disponon INSTAT</li> </ul> <p><b>2. Trajtimi i mos-përgjigjeve</b></p> <p>Konsiderohen si mos-përgjigje të gjitha rastet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Pa kontakt</li> <li>Refuzim i plotë</li> <li>Refuzime të pjesshme (për variabla apo tregues të veçantë).</li> </ul> <p>Për trajtimin e mos-përgjigjeve të pjesshme u përdorën disa metoda të drejtpërdrejta ose kombinimi i tyre si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Studimi i serisë kohore;</li> <li>Imputime sipas metodës me ngjashëri në nivel variablash demografik duke përdorur programet kompjuterike SCIA dhe RIDA;</li> </ul>				
18.6. Rregullimi	Asnjë përshtatje sezonale nuk i bëhet të dhënave të grumbulluara nga ABF.				
<b>19. Komentë</b>					
<b>Aneks</b>					
<b>Tabela A1. Vlerësimet e shpenzimeve mesatare të konsumit dhe treguesit e cilësisë për 12 grupet kryesore</b>					
Grupet	Vlerësimi i shpenzimeve për konsum	Devijimi Standard	Intervali i besimit 95%		Koeficienti i variacionit
			I poshtëm	I sipërm	

Shpenzimet mesatare gjithsej	88.367	1.193	86.026	90.708	1,35
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	35.083	419	34.261	35.905	1,19
Pije alkoolike dhe duhan	3.673	117	3.442	3.903	3,20
Veshje dhe këpucë	4.384	166	4.058	4.711	3,80
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar	8.640	117	8.411	8.869	1,35
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës	5.719	131	5.461	5.976	2,30
Shëndet	3.760	152	3.463	4.058	4,03
Transport	6.123	222	5.687	6.558	3,62
Komunikim	3.459	41	3.378	3.540	1,19
Argëtim dhe kulturë	2.409	146	2.122	2.695	6,07
Arsim	3.099	370	2.373	3.825	11,94
Restorante dhe hotele	6.448	224	6.008	6.888	3,48
Të tjera mallra dhe shërbime	5.570	117	5.340	5.800	2,10

**Tabela A2. Vlerësimet e shpenzimeve mesatare të konsumit dhe treguesit e cilësisë sipas qarqeve**

Qarku	Vlerësimi i shpenzimeve për konsum	Devijimi Standard	Intervali i besimit 95%		Koefficienti i variacionit
			I poshtëm	I sipërm	
Shpenzimet mesatare gjithsej	88.367	1.193	86.026	90.708	1,35
Berat	82.850	2.838	77.280	88.420	3,43
Dibër	72.724	4.483	63.925	81.523	6,16
Durrës	83.473	3.265	77.064	89.882	3,91
Elbasan	75.899	1.851	72.267	79.531	2,44
Fier	83.371	2.317	78.824	87.917	2,78
Gjirokastrë	81.522	6.426	68.910	94.135	7,88
Korçë	85.398	2.399	80.689	90.108	2,81
Kukës	73.099	3.989	65.270	80.928	5,46
Lezhë	82.557	5.154	72.441	92.673	6,24
Shkodër	83.014	4.693	73.802	92.225	5,65
Tiranë	104.426	2.956	98.623	110.228	2,83
Vlorë	79.337	3.572	72.326	86.348	4,50